

KËRKESË
Nr.1510, datë 20.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMEVE PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “HAJDIN ÇUNI” dhe “KURT ARUÇI”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- 1. “HAJDIN ÇUNI”**
- 2. “KURT ARUÇI”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIM
Nr. 3460, datë 9.7.2018

I KOMSIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me Nr. 1 datë 6.4.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit “Hajdin Cuni” protokolluar me Nr. 1557, prot., datë 12.4.2018

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me nenin 2, të ligjit nr. 5/2016, datë 4.2.2016 “Për shpalljen e Moratoriumit të Pyjeve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë nga ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 1, datë 6.4.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 5 000 000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Hajdin Çuni” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
i komanduar në detyrë
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM
Nr. 5952, datë 30.10.2018

I KOMSIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 103, datë 4.2.2015 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve ”, i ndryshuar me vendimin nr. 694, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 1, datë 6.4.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit “Kurt Aruçi” protokolluar me nr. 4128, prot., datë 8.8.2018

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me piken 1/q, të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 10, datë 4.8.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 80 000 lekë, dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Kurt Aruçi” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.